



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly**

**Legjislatura III
Sesioni vjeshtor**

Seancë plenare e Kuvendit

P- 091

Prishtinë, më 26 nëntor dhe 3 dhjetor 2009, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 26 NËNTOR DHE MË 3 DHEJTOR 2009**

Seancën e drejtoi **Xhavit Haliti**, anëtar Kryesisë së Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se në seancë janë të pranishëm 63 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Në fillim të seancës, deputetja **Flora Brovina**, në emër të Grupit Joformal të Grave të Kuvendit, propozoi që Kuvendi në seancën e sotme të miratojë rezolutën për nxjerrjen e Ligjit kundër dhunës në familje.

Kryesuesi tha se nismat ligjore duhen të parashtrohen në përputhje me rregullat e procedurës së Kuvendit.

Në vazhdim, kryesuesi i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Debat për Raportin e Komisionit Evropian për progresin në Kosovë për vitin 2009, sipas kërkesës së Komisionit për Integritet Evropian dhe të Grupit Parlamentar të LDD-së

Kryesuesi njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit, ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit, që në seancë plenare të debatohet për Raportin e Komisionit Evropian për Progresin në Kosovë për vitin 2009. Komisioni për Integritet Evropian ka rekomanduar që të diskutohet në seancë plenare Raporti i Komisionit Evropian për Progresin në Kosovë për vitin 2009, si dhe e ka proceduar për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, Propozim- planin e veprimtari të Kuvendit për integritet evropian.

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të LDD-së, që ta marrë fjalën.

Shefi i Grupit Parlamentar i LDD-së **Lulzim Zeneli** tha se Raporti i Progresit i Komisionit Evropian është parametër i rëndësishëm për të kuptuar dhe për të pasqyruar nivelin e progresit të institucioneve të Kosovës në procesin e integriteteve Evropiane, prandaj Grupi Parlamentar i LDD-së ka kërkuar debat parlamentar për këtë temë.

Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2009, vlerëson se nga viti i kaluar deri në shtator të këtij viti, në Kosovë janë shënuar ngecje të mëdha, trendë negativ dhe përkeqësim i gjendjes në fushat kryesore që identifikojnë frymëmarrjen e funksionimit të shtetit dhe të demokracisë. Për atë kohë sa ne dimë se Kosova ka filluar të vlerësohet nga ana e Bashkimit Evropian me anë të Progres- raportit, asnjëherë nuk ka ndodhur të hartohet një raport i tillë atë kritik për punën e institucioneve në vend, duke i përdorur sektorët secilin veç e veç.

Në vitin 2006 Kosova kishte bërë progres në përmbushjen e obligimeve të saja ndërkombëtare dhe atyre rajonale, por që nga atëherë progresi është ndaluar. Në fushën e demokracisë dhe sundimit të ligjit, situata në Kosovë është përkeqësuar nga viti 2007.

Ai theksoi se korrupsioni mbetet dominues në shumë fusha në Kosovë dhe vazhdon të jetë çështje shumë shqetësuese, ndërsa, me këta trendë negativ dhe tejet brengosës dëshmohet se nuk ishin institucionet ndërkombëtare ato që nuk ofruan shansin për prosperitet, por ishte puna joserioze, mungesa e vullnetit politik dhe kriteret e paplotësuara nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të garantuar dhe për t'iu qasur lëvizjes së lirë të qytetarëve të Kosovës dhe perspektivës së liberalizimit të vizave. Dhe, çështja tjetër që mbetet, është promovimi i mëtejshëm i agjendës Evropiane për Kosovën. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, ftoj të gjithë deputetët të marrin pjesë aktive në këtë debat.

Kryesuesi ftoi kryetaren e Komisionit për Integritet Evropian, Zylfie Hundozi, si propozues, që ta marrë fjalën.

Kryetarja e Komisionit për Integritet Evropian, **Zylfie Hundozi**, tha se Komisioni për Integritet Evropian ka mbajtur mbledhjen e rregullt dhe mbledhje me përfaqësuesit e Komisionit Evropian, që e prezantoi zyrtarisht para Komisionit- Raportin e Progresit për Kosovën. Mbajtëm dëgjim publik me shoqërinë civile si edhe punëtori dyditore me ç'rast u debatua për gjetjet e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2009, si edhe rrugët të cilat Kosova duhet t'i ndjekë që sa më shpejtë të integrohet në Bashkimin Evropian. Komisioni duke u nisur nga fakti që Kuvendi i Kosovës ka përgjegjësi domethënëse në realizimin e agjendës evropiane si trup legjislativ i vendit, detyra kryesore e të cilit është të miratojë ligje të cilat janë në harmoni të plotë me aquì communautaire, Komisioni ka kërkuar përkrahje nga Komisioni Evropian, të cilën përkrahje edhe e ka marrë me anë të ekspertit ndërkombëtar që ta ndihmojë punën e këtij Komisioni.

Ajo theksoi se mungesa e strategjisë për zhvillim ekonomik, i cili për shkak të **kësaj mungese edhe pse ishte prioritet në programin** e Qeverisë, ka pak zhvillim në krahasim me katër raportet e kaluara që janë dhënë për Kosovën. Zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit për Kuvend në tërësi do të ishte një mekanizëm i mirë për përmbushjen e kësaj sfide të Kuvendit ndaj Qeverisë, si edhe përkrahja e shtuar financiare ndaj komisioneve parlamentare për kryerjen e punës së tyre.

Njëri prej rekomandimeve të ardhshme do të ishte që këshilli, i cili përfshin autoritetet më të larta politike, duhet urgjentisht të takohet, në mënyrë që të kontribuojë sa më shumë në këtë proces.

Nga eksperiencia e vendeve që janë kandidate potenciale për Bashkimin Evropian dhe ato që janë anëtarësuar kohëve të fundit, kuptojmë se anëtarësimi është një proces i gjatë, i cili, me gjithë vendosmërinë e institucioneve dhe ndihmës së miqve ndërkombëtar, do të zgjasë, me gjithë punën intensive, 8 deri 10 vjet. Por, megjithatë ne duhet ta kemi një plan afatgjatë për procesin e integriteteve evropiane, jo afatshkurtër, siç e kemi pasur në vitin 2008 – 2010, pra duhet t'i caktojmë vetës afate kohore se kur do të arrijmë cakun tonë, të gjejmë mjete financiare dhe të sigurojmë resurse të mjaftueshme njerëzore, këtu e nënkuptoj reformën në administratën publike. Kohën që e kemi në disponim duhet ta shfrytëzojmë në mënyrë sa më efikase që t'i forcojmë institucionet, të bëjmë reforma sociale dhe të krijojmë prosperitetin ekonomik.

Kryesuesi hapi debatin për Raportin e Komisionit Evropian për progresin në Kosovë, për vitin 2009 dhe për Propozim -planin e veprimit të Kuvendit për Integritetin Evropian

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me raportin e Komisionit Evropian për progresin në Kosovë për vitin 2009, sipas kërkesës së Komisionit për Integritet Evropian dhe të Grupit Parlamentar të LDD-së dhanë këta deputetë. Kryeministri i Republikës së Kosovës, **Hashim Thaqi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Hydajet Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Sabri Hamiti**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Njomza Emmini**, në emër të Grupit Parlamentar "7+", **Xhezair Murati**, si dhe deputetët: **Suzan Novobrdaliu**, **Gani Geci**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, si dhe

deputetët: **Emrush Xhemajli, Ramadan Avdiu, Sanije Aliaj, Bajram Kosumi, Qamile Morina, Ibrahim Makolli, Ramë Buja**. që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, shtyu seancën plenare, për datën 3 dhjetor 2009

Vazhdimi i seancës plenare

E enjte, më 3.12. 2009, ora 10:00

Seancën e drejton Kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi

Kryetari njoftoi deputetët për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 26 nëntor 2009 lidhur me debatin për Raportin e Komisionit Evropian për Progresin në Kosovë, për vitin 2009, sipas kërkesës së Komisionit për Integritet Evropian dhe të Grupit Parlamentar të LDD-së.

Kryetari ftoi shefat e grupeve parlamentare që ta marrin fjalën.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja** tha se në emër të Grupit Parlamentar dhe të 46 deputetëve edhe të grupeve të tjera, kërkojmë që sot në orën 14,00 të mbahet një seancë të jashtëzakonshme.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri** tha se Grupi Parlamentar i LDK-së, pas njoftimit me vendimin e ri të Kryesisë, e mbështet qëndrimin e Kryesisë së Kuvendit.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini** tha se debati nuk do t'i ndihmojë drejtësisë dhe nuk jemi të interesuar të marrim pjesë në debat në këtë fazë, i cili vetëm do t'i komplikojë çështjet edhe më tepër dhe do të ndërhyjë drejtpërdrejt në punën e gjyqësorit.

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Gashi** tha se e mbështet qëndrimin e Kryesisë për një seancë të rregullt për këtë çështje.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli** tha se grupi ynë parlamentar mbështet qëndrimin e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me raportin e Komisionit Evropian për Progresin në Kosovë për vitin 2009, sipas kërkesës së Komisionit për Integritet Evropian dhe të Grupit Parlamentar të LDD-së dhanë këta deputetë: **Ramë Buja, Ibrahim Gashi, Myzejene Selmani, Riza Smaka, Gjylnaze Syla, Berim Ramosaj, Numan Baliq, Armend Zemaj, Donika Kadaj-Bujupi, Hajredin Kuçi, Mimoza Ahmetaj, Lutfi Haziri, Kaqusha Jashari, Naser Rugova, Besa Gaxherri, Kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, Memli Krasniqi, Dritan Tali, Edita Tahiri, Bahri Hyseni, Nait Hasani dhe Gani Buçinca.**

Në fund për fjalë u paraqiten propozuesit e debatit.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, theksoi se debati i zhvilluar ishte mjaft përmbajtjesor dhe mund të vij në përfundim se janë ofruar shanse nga komuniteti evropian për ndryshimin e jetës së qytetarëve të Kosovës dhe promovimin e Kosovës në agjendën evropiane. Ajo çka mund të përfundojmë dhe duhet ta kemi parasysh është se Kuvendi i Kosovës dhe qytetarët e Kosovës tashmë e kanë të qartë se ajo çka është thënë, pra nuk po i përsëris parafolësit, korrupsioni, regresi ekonomik, si dhe aspekte të tjera, ndikuan dhe reflektuan negativisht, por nuk u morën seriozisht nga ana e institucioneve të Kosovës. Pra, ato janë: institucionet qeveritare jo profesionale që merren me procesin e integritetit evropian, puna jo **rezultative** e Kuvendit të Kosovës në mbikëqyrjen e Qeverisë, koordinimi, do të thosha, jo efikas, për mos të thënë, mos koordinimi ndërministror, mungesa e vullnetit politik të Qeverisë dhe mungesa e politikave operacionale në aspektin e integriteteve evropiane. Dhe, ajo që vlen të theksohet se mos përmbushja e kriterëve që dalin nga plani i punës së partneritetit evropian, siç janë kriteret politike, ekonomike dhe agjenda evropiane, po e vështirësojnë rrugën e Kosovës drejt BE-së, kështu që këto kriterë tani janë të rëndësishme për institucionet e Kosovës.

Në emër të Komisionit për Integritet Evropian, **Zylfie Hundozi** theksoi se Komisioni për Integritet Evropian në mbledhjet e veta të mbajtura dhe në dëgjimin publik që e ka mbajtur me shoqërinë civile, në punëtorinë dyditore, ku kanë qenë të ftuar edhe të gjithë kryetarët e komisioneve, dhe në mbledhjet e Komisionit për planin e veprimit, ne e kemi hartuar për këtë qëllim, domethënë, për t' i ndihmuar proceseve të integriteteve evropiane të Kosovës. Edhe Komisioni Evropian, sa i përket Raporti i progresit, ka për qëllim që me anë të atyre kritikave në realitet t' ia hapë sytë Kosovës se në të cilat veprime duhet të përqendrohet për t' i plotësuar kushtet për anëtarësim në Bashkim Evropian. Lidhur me Ligjin për shërbyesit civilë, Komisioni e ka hartuar këtë plan të veprimit dy ditë pasi ka dalë raporti zyrtar i progresit. Më **datën 14 ka dalë raporti i progresit, më 18-19**, ne kemi mbajtur dëgjime publike, kemi mbajtur punëtori dy ditore, kështu që kur i kemi shkruar ne, ai ka qenë ende si vërejtje në Raportin e progresit dhe se krejt plani i veprimit u referohet sfidave.

Kryetari kërkoi nga komisionet parlamentare që ta shqyrtojnë Planin e veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian, secili nga fushëveprimi i vet, dhe vërejtjet eventuale, sugjerimet dhe propozimet, t'ia dërgojnë Komisionit për Integritet Evropian, para se të procedohet për miratim në Kuvend.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 17: 00 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**